



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA DROPULL

DREJTORIA E SHËRBIMIT URBAN DHE SHËRBIMEVE PUBLIKE

SPECIFIKIME TEKNIKE

OBJEKTI:

“ SHTRIM ME BETON I SEGMENTEVE TE RRUGES POLIÇAN - SOPIK “

1. SPECIFIKIME TE PERGJITHESHME

1.1 SPECIFIKIME TË PËRGJITHSHME

Në përgjithësi njësitet matëse janë njësi metrike në mm, cm, ml, m², m³, Km, N (Njuton), Mg (1000 kg), ton dhe gradë celcius. Pikat dhjetore janë të shkruara si “.”.

1.2 GRAFIKU I PUNIMEVE

Grafiku i punimeve është një program që tregon rendin, procedurën dhe metodën që punohet në ndërtim deri në mbarim të punës.

1.3 PUNIME TE GABUARA

Çdo punë, që nuk është në përputhje me specifikime, duhet refuzuar dhe kontraktuesi duhet të riparojë çdo defekt me shpenzimet e veta, sipas projektit.

1.4 SIGURIA NË PUNË

Gjatë kryerjes të punimeve, kontraktuesi duhet të marrë të gjitha masat mbrojtëse sipas legjisllacioneve në fuqi.

Gjatë kryerjes së punimeve, të gjithë punëtorët duhet të vishen me veshje të përshtatshme mbrojtëse ose mjete mbrojtëse si: helmata, syze, mbrojtëse, mbrojtëse veshësh, etj.

Kontraktori duhet të sigurohet se vendi dhe pajisjet janë :

- a) Të një tipi dhe standarti të përshtatshëm duke iu referuar vendit dhe llojit të punës që do të kryhet.
- b) Të siguruar nga një teknik kompetent dhe me eksperiencë.
- c) Të ruajtura në kushte të mira pune gjatë përdorimit.

2. PUNIME DHEU, GËRMIME DHE MBUSHJE

2.1 PUNIME DHEU

Ky seksion përmban përcaktimet e përgjithshme dhe kërkesat për punimet e gërmimeve në tokë (në vëllim dhe/ose me shtresë) dhe gërmimet për struktura në kanale. Me tej ajo mbulon të gjitha punimet që lidhen me konstruksionin e prerjeve, largimin e materialeve të papërshtatshme në hedhurina, dhe rifiniturat e shpatit të prerjes.

2.1.1 PËRGATITJA E FORMACIONEVE

Përgatitja e formacioneve përfshin këto punë:

- Njohja dhe saktësimi i vendodhjes së instalimeve nën tokë (Tubat e shkarkimit të ujërave, Tombinot).
- Matja dhe përcaktimi i terrenit të kryerjes së punimeve.

- Heqja e dheut, hapja e kanaleve të menjanimi të ujerave dhe transportimi i inerteve apo ripërdorimi i tyre.

2.1.2 PERPUNIMI I PJERESIVE

Në rastet e terrenit me pjerrësi veprohet sipas tre mënyrave të mëposhtme:

- Nivelimi i pjerrësisë sipas pikës më të ulët të terrenit
- Mbushja e terrenit me material ekstra, deri në nivelin e pikës më të lartë të terrenit
- Gërmime dhe mbushje sipas pikës mesatare.

Secila nga këto raste do të përdoret në varësi të llojit të dheut.

2.2 GËRMIME DHE MBUSHJE

2.2.1 GËRMIME

Gërmimi i dheut për nivelimin ose për punime gërmimi,

2.2.2 MBUSHJET

Shtresë me materiale inerte, gurë, rere, dheu në shtresa të ngjeshura mirë. Të gjitha materialet që rezultojnë nga gërmimet, do të kontrollohen më parë nga Supervizori dhe ripërdorimi i tyre do të autorizohet nga ai.

2.2.3 PËRDORIMI I MATERIALIT TË GËRMUAR

Materiali i përshtatshëm nga gërmimet do të përdoret për rimbushje. Çdo material i tepërt do të jetë në dispozicion të mungesave të materialeve të kërkuara.

3. PUNIME BETONI

3.1 BETONI I DERDHUR NË VEND

3.1.1 KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR BETONET

Betoni është një përzierje e çimentos, inerte të fraksionuara të rërës, inerte të fraksionuara të zhavorit dhe ujit dhe solucioneve të ndryshme për fortësinë, përshkueshmërinë e ujit dhe për të bërë të mundur që të punohet edhe në temperatura të ulëta sipas kërkesave dhe nevojave teknike të projektit

3.1.2 MATERIALET

Përbërësit e Betonit

Përbërësit e betonit duhet të përmbajnë rërë të larë ose granil, ose përzierje të të dyjave si dhe gurë të thyer. Të gjithë agregatët duhet të jenë pastruar nga mbeturinat organike si dhe nga dheu.

Çimento

Çimento duhet të shperndahet ne paketa origjinale te shenuara te pa demtuara direkt nga fabrika dhe duhet te ruhet ne nje depo i cili te jete e ngritur nga toka.

Uji për beton

Uji që do të përdoret në prodhimin e betonit duhet të jetë I pastër nga substancat që dëmtojnë atë si: acidet, alkalidet, argila, vajra si dhe substanca të tjera organike

3.1.3 DEPOZITIMI I MATERIALEVE

Depozitimi i materialeve që do të përdoren për prodhimin e betonit duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- Çimentoja dhe përbërësit duhet të depozitohen në atë mënyrë që të ruhen nga përzierja me materiale të tjera, të cilat nuk janë të përshtatshme për prodhimin e betonit dhe e dëmtojnë cilësinë e tij.
- Çimentoja duhet të depozitohet në ambiente pa lagështirë dhe që nuk lejojnë lagjen e saj nga uji dhe shirat.

3.1.4 KLASIFIKIMI I BETONEVE

Beton klasa C-16/20 me inerte, konsistencë 3 – 5 cm, granil deri në 20 mm, rërë e larë me modul

2,6: Çimento marka, 300 kg, rërë e larë 0,43 m³, granil 0,69 m³, ujë 0,18 m³.

3.1.5 PRODHIMI I BETONIT

Betoni duhet të përgatitet për klasen e përcaktuar nga projektuesi dhe receptura e përzierjes së materialeve sipas saj në mbështetje të rregullave që jepen në KTZ 37 – 75 “Projektim i betoneve”.

3.1.6 HEDHJA E BETONIT

Hedhja e betonit të prodhuar në vend bëhet sipas mundësive dhe kushteve ku ai do të hidhet. E rëndësishme në procesin e hedhjes së betonit në vepër është koha nga prodhimi në hedhje, e cila duhet të jetë sa më e shkurtër.

3.1.7 MBROJTJA

Betoni i freskët duhet mbrojtur nga këto ndikime:

- Shiu si dhe lagështi të tjera duke e mbuluar sipërfaqen e betonuar me plastmas dhe materiale të padepërtueshme nga uji
- Ngricat (duke i futur gjatë procesit të prodhimit solucione kundra temperaturave të ulta mundet të betonohet deri në temperatura afër zeros.
- Temperatura të larta. Betoni mbrohet ndaj temperaturave të larta duke e lagur vazhdimisht atë me ujë, në mënyrë të tillë që të mos krijohen plasaritje.

3.1.8 BETONI NË KUSHTE TË VËSHTIRA ATMOSFERIKE

Rekomandohet që prodhimi dhe hedhja e betonit në objekt të mos realizohet në kushte të vështira atmosferike.

Ndalohet prodhimi dhe hedhja e betonit në rast se bie shi i rrëmbyeshëm, pasi nga sasia e madhe e ujit që i futet betonit largohet çimentoja dhe kështu që betoni e humb markën që kërkohet. Në rastet e temperaturave të ulta nën 4 °C rekomandohet të mos kryhet betonimi, por n.q.s kjo është e domosdoshme, atëherë duhet të merren masa që gjatë procesit të prodhimit të betonit, atij t'i shtohet solucionin ndaj ngricave në masën e nevojshme që rekomandohet nga prodhuesi i këtij solucion. Prodhimi dhe përpunimi i betonit në temperatura të larta mund të ndikojë negativisht në reagimin kimik të çimentos me pjesët e tjera të betonit. Për këtë arsye ai duhet ruajtur kundër temperaturave të larta. Mënyra e ruajtjes nga temperatura e lartë mund të bëhet në atë mënyrë, që betoni i freskët të mbrohet nga dielli duke e mbuluar me plasmas, tallash dhe duke e stërkatur me ujë. Një ndihmë tjetër për përpunimin e betonit në temperatura të larta është të ngjyrosësh mbajtësit e ujit me ngjyrë të bardhë dhe të sigurojë spërkatje të vazhdueshme me ujë.

SHENIME

Sasia e materialeve të çimentos dhe të zgares së hekurit do të sigurohen nga Bashkia Dropull. Te gjitha zerat e tjere janë të llogaritura në prentativin përkatës sipas Manualeve dhe analizave përkatëse.

HEKURI PER BETON TE ARMUAR

Te Pergjithshme.

Pesha e shufrave të drejta të hekurit për armimin e betonit të tipit Fe B 22k, Fe B 32k ose të tipit special me kufi të lartë elasticiteti, do të përcaktohet me anë të peshës teorike që i korrespondon diametrave të ndryshëm të përshkruar, pa marrë parasysh sasitë që janë me të mëdha se ato të përshkruara, shtrenguesit, distanciatorët dhe mbivendosjet e lidhjeve të padetajuara në vizatimet e projektit ose jo duke nënkuptuar ato domosdoshmërisht, gjithashtu ato që lidhin shufrat me gjatësi me të vogël se tipi që tregohet. Në çdo rast pesha e hekurit do të përcaktohet me mjete të zakonshme analitike, që janë: Duke matur gjatësinë efektive lineare të çdo shufre dhe duke e shumezuar me peshën njësi të përcaktuar mbi bazën e dimensioneve nominale me peshe volumore 7.85 kg/dm³. Pesha e shufrave të çelikut të viaskuar Fe B 38k dhe Fe B 44k, gjithashtu për seksion jo rrethor do të përcaktohet duke shumezuar gjatësinë lineare të elementit me peshën njësi të shufres që i korrespondon seksionit nominal të përcaktuar mbi bazën e peshës volumore 7.85 kg/dm³.

Armimi i shtresës së betonit në këto objekt do të bëhet me zgara hekuri Ø(3-5)mm kuadrat (15x15)cm. Hekuri në Zgarat e hekurit është i salduar e në veper do të bëhet vetëm lidhja e zgarave me njëra tjetrën me tel bari të zakonshëm me mbivendosje të zgarave me gjatësi (20 -30) cm. Zgarat janë me dimensione (5x10)m. Gjate transportit për në veper të bëhet kujdes për të ruajtur zgarat nga demtimet mekanike që mund të demtojnë lidhjen e hekurit.

Ing. Gaqe Meçi

Ing. Arjan Tusha